



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KRYETARI

V E N D I M

Nr. 108 Datë 18.03.2021

PËR PËRCAKTIMIN E VENDEVE PUBLIKE NË TERRITORIN E BASHKISË DIBËR
PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE NGA PARTITË POLITIKE
PËR ZGJEDHJET E DATËS 25 PRILL 2021

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, detyrimeve ligjore që na ngarkon pika 1 e nenit 79 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.

V E N D O S A:

Përcaktimin e vendeve publike në Bashkinë Dibër për afishimin e materialeve propagandistike nga partitë politike gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet qendrore të datës 25 Prill 2021 si më poshtë vijon:

1. Njësia Administrative Peshkopi

- Segmenti rrugor ish NBSH deri ish SMT
- Bulevardi “Elez Isufi”
- Lagjet “Dobrovë”, “Kamen”, “Gjok Doçi” dhe “Nazmi Rushiti”

2. Në njësitë e tjera administrative, përkatësisht në **Maqellarë, Melan, Tomin, Kastriot, Fushë Çidhën, Arras, Muhurr, Luzni, Sillovë, Kala e Dodës, Zall Dardhë, Zall Reç, Selishtë, Lurë**, afishimi i materialeve propagandistike për fushatën e zgjedhjeve të datës 25 Prill 2021, **do të lejohet** vetëm në qendrat(mjediset publike) të njësive administrative.

3. Nga sa më lartë dhe sipas përcaktimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 79 të Kodit Zgjedhor, ku specifikohet se “*Gjatë fushatës zgjedhore përdorimi dhe afishimi i çdo materiali tjetër statik për propagandë zgjedhore, përfshirë flamujt dhe posterat, do të lejohet vetëm në një largësi prej deri 5 metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës*”, si dhe “*Të gjitha materialet propagandistike vizive që përdoren në*

fushatë duhet të shoqërohen me shënimin “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore...”(vijon emri i subjektit zgjedhor).

4. Çdo afishim në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 2 dhe 3 të nenit të sipërcituar, si dhe në kundërshtim me këtë vendim, është i ndaluar. Në të kundërt, Policia Bashkiake dhe Policia e Shtetit do të garantojnë zbatimin e detyrimeve ligjore që burojnë nga neni 79, duke hequr menjëherë materialet propagandistike jashtë përcaktimeve në pikat 1, 2 dhe 3 të po këtij neni.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi **Partitë Politike** dhe **Policia Bashkiake!**
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë!

KRYETARI I BASHKISË NË DETYRË

SHKËLQIM MURRJA

